



Vlerësim i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë:

Udhërrëfyesi për përmirësimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë



Porositësi i hulumtimit:

OJQ Aktiv

Autorë të hulumtimit:

Igor Marković

Caleb Waugh

Donator:

National Endowment
for Democracy (NED)

Për botuesin:

OJQ Aktiv

Adresa:

Mbreti Petar 183a,
Mitrovicë Veriore
Qamil Hoxha, kati 1,
banesa nr. 2, Prishtinë

E-mail:

info@ngoaktiv.org

Uebfaqja:

www.ngoaktiv.org

**Mitrovicë Veriore,
dhjetor 2023.**

VLERËSIM I STATUSIT TË TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË NË KOSOVË: UDHËRRËFYESI PËR PËRMIRËSIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE JO-SHUMICË

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Konteksti	7
Harta e problemeve kryesore	9
Boshnjakët	11
Goranët	12
Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët	13
Serbët	14
Turqit	15
Rekomandime	17

Ndonëse pasojat e pandemisë së COVID-19 mund të konsiderohen se janë zbehur pjesërisht gjatë vitit 2022 në shkallë globale, pushtimi rus i Ukrainës ka kontribuar ndjeshëm në thellimin e krizës politike dhe ekonomike në të gjitha aspektet. Ngritja e forcave politike populiste dhe të krahut të djathtë në Evropën Perëndimore i ka zhvendosur narrativat nga humanitare në ato që anojnë drejt prirjeve etno-centriste dhe izolacioniste për sa i përket spektrit ideologjik. Në rrethana të tilla, perspektiva e proceseve integruese euroatlantike në nivel rajonal është larguar nga skena kryesore politike, duke i hapur rrugën ngritjes së diskurseve autokratike dhe jo-liberale të karakterizuara nga retorika populiste që nuk kontribuuan në rritjen e normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe ndëretnike.

Përveç kësaj, ngërçi në procesin e normalizimit ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, i cili u përkeq nga zgjatjet e përhershme në vazhdimin e dialogut të lehtësuar, është perceptuar nga palët e interesuara rajonale dhe ndërkombëtare si kërcënim potencial për stabilitetin tashmë të brishtë politik dhe të sigurisë në Ballkani Perëndimor. Përkundër "shuttle" diplomacisë dinamike të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe disa vende të Evropës Perëndimore me synimin për të reduktuar risqet e mundshme të sigurisë, falë faktorëve të lartpërmendur duket se kjo qasje nuk dha fryt. Ciklet e përhershme të krizave politike në Kosovë, pjesërisht të shtytura nga mungesa e progresit në procesin e normalizimit, kanë ulur potencialin e një platforme të qëndrueshme për rregullimin e marrëdhënieve ndëretnike pas konfliktit dhe adresimin e çështjeve që lindën nga traumat e pasluftës. Si rezultat i mungesës së zgjidhjeve afatgjata dhe afatshkurtra për probleme të ndryshme për të cilat ishin projektuar marrëveshjet teknike të nënshkruara më parë, çështjet si ri-regjistrimi i targave, dilemat e sigurisë dhe integrimi i sistemit energjetik në veri të Kosovës, formimi i Asociacionit / Bashkësisë së komunave me shumicë serbe, janë kthyer si bumerang në formën e një krize të simbolizuar nga braktisja e institucioneve të Kosovës nga pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës dhe ngritja e barrikadave në veri.

Raporti i këtij viti, i cili përfshin periudhën janar-dhjetor 2022, do të ndryshojë pak për nga forma dhe përmbajtja nga raportet e mëparshme të natyrës së ngjashme të publikuara nga OJQ AKTIV. Ndonëse AKTIV vazhdoi të qëndrojë në hap me zhvillimet që prekin komunitetet jo-shumicë në Kosovë, dhe këtë e pasqyroj në raportimin e vet, meqë janë me rëndësi vendimtare dhe në të vërtetë gur themeltar i jetës organizative, përkeqësimi i marrëdhënieve ndëretnike, përkatësisht marrëdhënieve institucionale

(ose më mirë të themi, mungesa e këtyre) ndërmjet serbëve të Kosovës dhe institucioneve qeverisëse të nivelit qendror vuri në pah nevojën për ndryshim në fokus dhe qasje. Ndërsa hulumtimi i mëparshëm u fokusua në marrjen dhe artikullimin e informacionit të mbledhur përmes punës intensive me komunitetet lokale, u bë e qartë se ekzistonte mungesë e dukshme e interesit nga aktorët politikë për të marrë parasysh nevojat e komuniteteve jo-shumicë të Kosovës, dhe se për më tepër pak e aspak përmirësim nuk mund të vërehet në vullnetin dhe gatishmërinë e institucioneve për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit që rregullon të drejtat e komuniteteve jo-shumicë.

Mund të argumentohet se, dhe duke lënë mënjanë çështjet politike më të mëdha dhe më jo-transparente në lidhje me procesin e dialogut, ndër shkaqet rrënjësore të problemit të përshkruar më sipër është në fakt mungesa e dukshme e progresit të prekshëm të shënuar në drejtim të respektimit të të drejtave të komuniteteve, çështje që përndryshe është gur themeltar i kornizës kushtetuese dhe ligjore të Kosovës. E thënë thjesht, krizat e përjetuara gjatë vitit 2022, veçanërisht në veri të Kosovës, janë çështje e sundimit të së drejtës dhe pasqyrim i drejtpërdrejtë i nivelit të lartë të shqetësimit që përjetojnë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë kur reflektojnë për pozitën e tyre të përgjithshme në ekosistemin socio-politik të Kosovës. Ndonëse shumë nga ngjarjet e atij viti mund të interpretohen në mënyra të ndryshme, ato shërbyen për të përkeqësuar ndjeshëm marrëdhëniet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe qeverisë qendrore, dhe në të vërtetë i shtynë shumë të vënë në dyshim qëndrueshmërinë afatgjatë të së ardhmes së tyre në Kosovë. Duke pasur parasysh urgjencën e situatës së shkuar dhe aktuale, u përcaktua se do të duhej të ketë fokus më të madh në rekomandimet që synojnë adresimin e ngërçit aktual që filloi në pranverën dhe verën e vitit 2022.

Krizat që do të përshkruhen më hollësisht në pjesët vijuese në këtë raport nuk janë shkak, por më tepër simptomë e çështjeve sistematike më të gjera dhe më të thella që kanë pllakosur Kosovën gjatë dekadës së shkuar dhe që në momentin e publikimit të këtij raporti, nuk tregojnë asnjë shenjë të qartë të lehtësimit.

Viti 2022 u shpalo, në pjesën më të madhe, i kapluar nga tensioni, i mbuluar me pasiguri dhe i shënuar nga shpërthime trazirash sporadike, veçanërisht në katër komunat veriore. Këto ngjarje do të ngjyronin shumë zhvillimet politike që do të ndodhnin në vitin 2023 dhe do të shërbenin për të lënë në hije diskutimet dhe përpjekjet lidhur me të drejtat dhe pozitën e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Kjo u ndie veçanërisht në sektorin e shoqërisë civile, pasi puna për çështje të tilla si të drejtat gjuhësore u la mënjanë për t'iu përgjigjur një sërë krizash që shfaqeshin me shpejtësi. Këto kriza, ndërsa mbase të rrënjësura në mungesën e progresit të shënuar në procesin e dialogut Beograd-Prishtinë, patën efekt shkatërrues në jetën e përditshme të banorëve të katër komunave veriore, jo vetëm sepse shkaktuan shumë presion psikologjik mbi komunitetet lokale, por sepse ato po ashtu, në shumë raste, përbënin kërcënim që për një numër të madh të qytetarëve ishte shumë ekzistencial.

Fundi i janarit dhe fillimi i shkurtit 2022 u shënuar me hyrjen graduale të njësisë të forcave speciale në veri, si dhe me fillimin e ndërtimit të bazës së forcave speciale në afërsi të pikës së kalimit të kufirit në Bërnjak.¹ Në muajt që vijuan pati një varg mosmarrëveshjesh në lidhje me kërcënimet nga autoritetet e nivelit qendror përkitazi me përdorimin e dokumenteve të identifikimit gjatë hyrjes/daljes nga Kosova, dhe përdorimin e targave me shenja "KM".^{2,3} Kjo shkaktoi trazim të konsiderueshëm në mesin e komuniteteve lokale, pasi shumë prej tyre kishin qoftë vetura me targa të lëshuara nga Serbia ose dokumente identiteti të lëshuara nga Serbia dhe kishin frikë qoftë për jetesën e tyre ose për mundësinë e tyre afatgjatë për të qëndruar në Kosovë.⁴ Muajt e verës së vitit 2022 u dëshmuar veçanërisht të tensionuar, me vazhdimin e insistimit nga Prishtina për regjim reciprok për kalimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me letërnjoftim, me dështim në vazhdimësi për të shënuar përparim në bisedimet e dialogut dhe përsëritjen e vazhdueshme të kundërshtimit të Prishtinës për formimin e Asociacionit/Bashkësisë së Komunave me shumicë serbe të Kosovës.^{5,6}

Situata arriti në nadir në nëntor dhe dhjetor të vitit 2022, kur serbët e Kosovës shpallën tërheqjen e tyre nga institucionet e Kosovës për shkak të pezullimit të Nenad Djurić si komandant i policisë në veri. Kjo përfshiu dorëheqjen e kryetarëve të katër komunave veriore, dorëheqjet masive të policëve të Kosovës në të njëjtën zonë, në sektorin e drejtësisë dhe në Kuvendin e Kosovës dhe ngritjen e barrikadave në lokacione të ndryshme anekënd veriut. Ndonëse vendimi u kritikua gjerësisht dhe u ushtrua presion i madh mbi aktorët politikë nga komuniteti serb i Kosovës, si dhe mbi

¹ KosSev, Betonski blokovi kod Brnjaka, Kosovska policija postavlja bazu pogranične policije, 2022, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/betonski-blokovi-kod-brnjaka-kosovka-policija-postavlja-bazu-pograncicne/>

² KosSev, Svećlja: Odluke o reciprocitetu se primenjuju od 1. septembra, o tome se neće razgovarati u Briselu, 2022, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/sveclja-odluka-o-reciprocitetu-se-primenjuju-od-1-septembra-o-tome-se-neece-razgovarati-u-briselu/>

³ Mosmarrëveshja lindi në lidhje me përdorimin e gjerë të targave të lëshuara nga Serbia me shenja të qyteteve në Kosovë, të cilat nga autoritetet kosovare konsiderohen të kundërligjshme.

⁴ Bazuar në grupet e fokusit dhe intervistat e kryera ndërmjet majit dhe qershorit 2023 në katër komunat veriore.

⁵ KosSev, *Priština ponavlja da je protiv ZSO, kritikuju SL da se ne bavi svakodnevnim problemima Srba na Kosovu*, 2022, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/pristina-ponavlja-da-je-protiv-zso-kritikuju-sl-da-se-ne-bavi-svakodnevnim-problemima-srba-na-kosovu/>

⁶ KosSev, *U Briselu danas bez ikakvog dogovora, razgovori se nastavljaju do 1. septembra*, 2022, në dispozicion këtu: <https://kossev.info/borelj-uoci-sastanka-u-briselu-obe-strane-da-budu-otvorene-vucic-ndam-se-resenju-ali-u-to-ne-verujem/>

Beogradin, masat gëzuan shkallë mjaft të madhe të mbështetjes nga komunitetet lokale, të cilët u ndien gjithnjë e më shumë nën presion dhe të frikësuar nga përkeqësimi i shpejtë i kushteve socio-politike në mjediset ku ata banonin.⁷ Në ditët e fundit të vitit 2022, më 29 dhjetor, presidenti serb Aleksandar Vučić njoftoi se barrikatat do të hiqen, duke shtensionuar situatën të paktën përkohësisht. Sidoqoftë, ngjarjet e vitit 2022 ishin paralajmëruese në masë të madhe për vitin 2023, gjatë të cilit përndryshe u pa vazhdimësi e luhatjeve të pandërprera të tensioneve që kishin karakterizuar vitin paraprak.

Mund të argumentohet se, ndër të tjera, një nga viktimat më të mëdha të ngjarjeve që ndodhën ishte mungesa e dukshme e progresit, apo edhe diskutimi publik për të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në strukturat institucionale të Kosovës (lokale apo qendrore.) Serbët në veri u lanë pa përfaqësim adekuat politik, ndërsa komunitetet e tjera jo-shumicë u lanë mënjanë pasi titujt në media dhe prioritetet politike u riorientuan me shpejtësi në modalitetin e “menaxhimit të krizës”, ashtu si edhe vëmendja e bashkësisë ndërkombëtare. Kjo u reflektua shumë gjatë procesit të kryerjes së hulumtimit për këtë punim, pasi shumica e diskutimeve u dominuan nga ngjarje të tilla si barrikatat, tërheqja e serbëve nga institucionet dhe ngjarje të tjera të ngjashme dhe jo te nevojat dhe problemet e përditshme të komuniteteve jo-shumicë.

⁷ Bazuar në grupet e fokusit dhe intervistat e kryera ndërmjet majit dhe qershorit 2023 në katër komunat veriore.

HARTA E PROBLEMEVE KRYESORE

Problemet, çështjet, pakënaqësitë dhe interesat kryesore të komuniteteve jo-shumicë të cilat janë identifikuar dhe shtjelluar në detaje nga OJQ AKTIV në *Vlerësimin e statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë për vitin 2020*⁸ dhe 2021⁹ i kanë ofruar komunitetit akademik dhe publikut të gjerë një pasqyrë të çështjeve që nuk janë trajtuar apo zgjidhur gjatë dy dekadave të fundit pas konfliktit. Meqenëse pjesa dërrmuese e çështjeve në fjalë nuk kanë ndryshuar për nga thelbi i natyrës, pra, moszgjidhja e problemeve vendimtare që ranë viktimë e mungesës së reagimeve institucionale dhe praktike nga palët e interesuara, ky raport nuk do të thellohet në imtimin e barrierave tashmë të analizuara për përmirësimin e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Prandaj, qëllimi i këtij publikimi do të jetë të përvijojë pikat kryesore të nxjerra nga aktivitetet e thelluara dhe gjithëpërfshirëse hulumtuese të kryera nga OJQ AKTIV dhe OSHC të tjera¹⁰ duke trajtuar problemet e komuniteteve jo-shumicë.

Pjesëmarrësit në intervistat dhe grupet e fokusit të kryera gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023 treguan tendencë për t'u fokusuar në sigurinë e tyre fizike të menjëhershme, si dhe shqetësim mbizotërues lidhur me dinamikën politike ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Në njëfarë mënyre, dhe thënë shumë përgjithësisht, problemet dhe diskutimet rreth çështjeve të të drejtave gjuhësore, qasjes në shërbime, trashëgimisë kulturore dhe të ngjashme janë përthithur kryesisht nga ajo valë krizash që nisën gjatë gjysmës së dytë të 2022. Një i intervistuar, nga një fshat i vogël dhe i izoluar në Kosovën perëndimore, përshkroi atmosferën e frikës dhe pasigurisë që përshkon komunitetin e tyre, dhe madje shkoi aq larg sa të përshkruante një plan ad-hoc për të ikur nga ajo trevë (në gusht të vitit 2022) nëse gjendja në veri do të përkeqësohej (dhe përhapej në pjesë të tjera të Kosovës) deri në atë masë që prania e tyre e vazhdueshme në ato vise të bëhej e paqëndrueshme.¹¹ Ndërsa ai skenar i veçantë nuk u realizua, mbase është shembulli më ekstrem i një modeli që u vu re kur flitej me bashkëbiseduesit për qëllimet e këtij hulumtimi: vështirësitë e përditshme të përjetuara në vitet e mëparshme vazhduan, kryesisht të pandryshuara, por urgjenca më e madhe iu kushtua kërcënimit të përshkallëzimit, i cili, në thelb, shihet si problem i natyrës ekzistenciale.¹² Të tjerë theksuan se krizat patën efekt serioz përcjellës në aspektin e marrëdhënieve dhe ndërveprimeve ndëretnike, veçanërisht në rajonin e gjerë të Mitrovicës, ku kombinimi i frikës dhe rritjes së ngurrimit për të "kaluar në anën tjetër" kontribuoi në tkurrjen e shtrirjes dhe thellësisë së kontaktit ndërmjet dy komuniteteve kryesore në ato vise.

Shumë banorë të viseve të banuara nga serbët e Kosovës, veçanërisht

⁸ NGO AKTIV, *Vlerësimi i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë* (2020), 2021, në dispozicion këtu: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/01/KosovoAlbweb.pdf>

⁹ NGO AKTIV, *Vlerësimi i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë* (2021), 2022, në dispozicion këtu: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/Final-ALB-Annual-Report.pdf>

¹⁰ Për qëllime të këtij publikimi u konsultuan analizat hulumtuese të publikuara nga Komunikimi për Zhvillim Social, Qendra Humane e Mitrovicës, Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve të Kosovës dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë.

¹¹ Bazuar në grupet e fokusit dhe intervistat e realizuara për qëllimet e këtij hulumtimi ndërmjet muajve mars dhe qershor 2023.

¹² Ibid.

por jo vetëm në veri, përmendën shqetësimet rreth ndërveprimeve me policinë dhe autoritetet e tjera, duke vënë në dukje se sjellja dhe qëndrimi i përgjithshëm ndaj tyre ishte përkeqësuar gjatë vitit të shkuar.¹³ Ndërsa anëtarët e komuniteteve të tjera jo-shumicë nuk kishin të njëjtat ankesa, disa vunë re se atmosfera e përgjithshme për pakicat, veçanërisht në aspektin e sfidave institucionale dhe zbatimit të legjislacionit (posaçërisht në lidhje me të drejtat gjuhësore), ishte bërë më sfiduese gjatë vitit 2022. Disa ia atribuuan këtë retorikës që buron nga partia në pushtet, e cila shpesh ka natyrë nacionaliste dhe shpesh përdor gjuhë që është përjashtuese ndaj qytetarëve jo-shqiptarë të Kosovës.¹⁴ Në fakt, shqetësimi mbi narrativat nacionaliste të nxitura nga aktorët politikë të nivelit qendror ishte temë e zakonshme në grupet e fokusit dhe intervistat, siç ishte edhe brenga se çështjet e vazhdueshme po liheshin anash ndërsa serioziteti i krizës vazhdoi të përkeqësohej gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022. Megjithëse qeveria e Kosovës u përpoq të përmirësonte fushëveprimin dhe thellësinë e afimit të saj me komunitetet jo-shumicë, veçanërisht përmes Zyrës për Çështje të Komuniteteve,¹⁵ shpesh në formën e granteve, subvencioneve dhe takimeve me organizatat e shoqërisë civile, kjo kishte vetëm efekt shumë të kufizuar në masën në të cilën marrëdhëniet institucionale u përmirësuan: shumë pjesëtarë, për shembull, të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, raportuan sfida të vazhdueshme, veçanërisht me rastin e qasjes në shërbimet publike. Kjo përkundër, sipas insistimeve të qeverisë së Kosovës, rritjes së investimeve dhe përpjekjeve për të sjellë pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në gjirin institucional të Kosovës dhe për të forcuar pjesëmarrjen e tyre në jetën politike. Nëse asgjë tjetër, në vitin 2022 u pa përkeqësim i ndjenjës së izolimit nga proceset politike, gjë që arriti në pikën më të ulët me tërheqjen e serbëve të Kosovës nga institucionet në veri.

Kur bëhet fjalë për komunitetet e tjera jo-shumicë, shumë shprehën shqetësimin se procesi i dialogut kishte konsumuar vëmendjen, jo vetëm nga perspektiva institucionale, por edhe brenda shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar.¹⁶ Pjesëtarët e komunitetit boshnjak të Kosovës raportuan probleme të vazhdueshme lidhur me aplikimin/implementimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ndërsa ndjenja dhe shqetësimet e ngjashme u theksuan nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në Graçanicë, të cilët vunë re probleme të vazhdueshme kur bëhet fjalë për qasjen e shërbimeve në gjuhën rome, e cila gëzon status zyrtar në atë komunë.¹⁷ Për më tepër, dhe veçanërisht për boshnjakët në veri të Kosovës, krizat që shënuan pjesën më të madhe të vitit 2022 gjithashtu përbënin një përkeqësim të problemeve para-ekzistuese të lidhura si me marrëdhëniet e tyre me serbët, ashtu edhe me pakicën shqiptare. Kjo nuk është thjesht çështje e 'besnikërisë', por çështje e natyrës politike dhe institucionale - megjithëse përballen me shumë nga të njëjtat probleme, veçanërisht në lidhje me të drejtat gjuhësore, boshnjakët kanë qenë më të prirë të pranojnë integrimin në sistemin e Kosovës, dhe për këtë arsye u gjendën në një pozitë veçanërisht të palakmueshme dhe sfiduese kur serbët u tërhoqën nga institucionet.

Gjithashtu duket se **qasja në dokumente** vazhdoi të jetë problem për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, veçanërisht për të kthyerit dhe ata të lindur pas vitit 1999. OJQ AKTIV, gjatë ecurisë së këtij hulumtimi, ka identifikuar një sërë rastesh¹⁸ të banorëve që nuk kanë

¹³ Ibid.

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Ibid.

¹⁸ NGO AKTIV, Vlerësimi i statusit të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, 2022, f. 27, në dispozicion këtu: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2023/03/Final-ALB-Annual-Report.pdf>

arritur të marrin dokumente të shtetësisë/identitetit për shkak të pengesave burokratike që kanë hasur. Në një numër rastesh, shtetësia ishte refuzuar me arsyetimin se individit në fjalë nuk ishte në gjendje të ofronte dokumentacionin e lëshuar nga institucionet e Kosovës që tregon se ata kishin lindur në territorin e Kosovës dhe/ose nga prindër që janë shtetas të Kosovës. Pretendohet se kjo mund të gjurmohet deri te udhëzimet administrative që parashikojnë, për personin që kërkon shtetësinë bazuar në parimin e *jus sanguinis*, që formularin e aplikimit ta nënshkruajnë të dy prindërit. Kjo është procedurë e pazakontë, pasi është aplikuar (të paktën në praktikë) si për të rriturit ashtu edhe për fëmijët. Është jashtëzakonisht e vështirë të përcaktohet numri i saktë i banorëve të nacionalitetit serb në Kosovë që përballen me këtë çështje, pasi refuzimet e kërkesave për shtetësi shpesh nuk shoqërohen me shpjegim të plotë dhe as nuk bëhen publike.

Më poshtë janë dhënë pesë problemet dhe nevojat thelbësore për komunitetet jo-shumicë që kërkojnë vëmendje dhe ndërhyrje të menjëhershme nga ana e institucioneve qeverisëse të nivelit lokal dhe qendror, bazuar në hulumtimin gjithëpërfshirës të kryer nga OJQ AKTIV në tre vitet e fundit në mesin e komuniteteve si vijon.¹⁹

¹⁹ Numërimi nuk nënkupton se paraqitet si listë sipas prioritetit.

Boshnjakët:

- 1** Përmirësimi i **cilësisë së arsimit** në gjuhën boshnjake ka rëndësi thelbësore. Kjo mund të arrihet duke siguruar disponueshmëri të vazhdueshme të teksteve mësimore dhe duke zgjeruar gamën e kurseve të ofruara në shkollat e mesme dhe universitetet në zonat ku boshnjakët përbëjnë pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Këto përpjekje janë jetike për të forcuar potencialin në rritje brenda komunitetit boshnjak në Kosovë. Përveç kësaj, ekziston nevoja për të ngritur cilësinë e shërbimeve të ofruara në gjuhën boshnjake përmes institucioneve të nivelit lokal dhe qendror.
- 2** Në përputhje me interesin e mëparshëm është nevoja për investime më transparente financiare dhe logjistike në projekte, ngjarje dhe iniciativa që synojnë të **mbrojnë dhe ruajnë gjuhën dhe identitetin kulturor** të boshnjakëve të Kosovës me anë të granteve financiare të ofruara më shpesh dhe në mënyrë më substanciale nga autoritetet e nivelit lokal dhe qendror.
- 3** Kapaciteti i komunitetit për **qasje në shërbime dhe informacione në gjuhën amtare boshnjake** përballet me pengesa substanciale për shkak të çështjeve të vazhdueshme strukturore që lidhen me respektimin e rregulloreve shumëgjuhëshe. Këto rrethana nënvizojnë nevojën për reforma sistemore dhe implementimin e mekanizmave të mbikëqyrjes që synojnë autoritetet lokale, të cilat mund të drejtohen nga institucionet e nivelit qendror dhe të lehtësohen nga Zyra e Komisionerit të Gjuhëve. Në këtë drejtim, mungesa e përkthimit konsektiv ose simultan në gjuhën boshnjake gjatë procedurave gjyqësore është një nga çështjet që duhet të adresohet urgjentisht.
- 4** Partitë politike që përfaqësojnë interesat e komunitetit boshnjak në Kosovë do të duhej të mëtojnë të krijojnë **ndjenjën e përbashkët të interesave që shkojnë përtej programeve të veçanta politike**.

Goranët:

Kjo duhet të përfshijë një proces i cili do të nxitet dhe do të konsistojë nga identifikimi dhe dhënia e prioritetit shqetësimeve thelbësore të cilat kërkojnë angazhim në avokim të përbashkët si në nivelet lokale ashtu edhe në ato qendrore të qeverisjes.

5 Për të rritur potencialin ekonomik dhe lirinë e lëvizjes për individët që i përkasin komunitetit boshnjak, është e domosdoshme që qeveria dhe autoritetet lokale të ndajnë fonde të shtuara për **përmirësimin e infra-strukturës rrugore** në zonat e thella ku banojnë anëtarët e komunitetit.

1 Ngjashëm me komunitetet e tjera etnike që flasin gjuhë sllave në Kosovë, është thelbësore që autoritetet lokale dhe qendrore të forcojnë zotimin e tyre për të zbatuar në mënyrë efektive Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve. Përveç kësaj, komuna e Dragashit do të duhej të konsiderojë emërimin e së paku një individi që flet rrjedhshëm **gjuhën gorane**, duke lehtësuar qasjen e përmirësuar në shërbimet komunale për ata që këtë gjuhë e kanë gjuhë amtare. Përkundër faktit se gjuha gorane ende nuk është e standardizuar, kjo nuk do të duhej të jetë pengesë për rritjen e përfshirjes së komunitetit goran në proceset e ofrimit të shërbimeve në gjuhën e tyre amtare.

2 **Përmirësimi i kushteve ekonomike dhe adresimi i papunësisë** në mesin e pjesëtarëve të komunitetit goran janë prioritetet kryesore, të cilat arrihen kryesisht me tejkalimin e barrierave gjuhësore. Kjo është thelbësore për përmirësimin e konkurrueshmërisë brenda tregut të punës në Kosovë, si dhe për të siguruar qasje më të mirë në shërbimet institucionale dhe komunikim efektiv me zyrtarët në gjuhën e tyre amtare.

3 Institucionet përkatëse do të duhej të **adresojnë çështjen e vazhdueshme të grabitjes dhe vjedhjes së pronës përgjatë rajoneve kufitare të komunës së Dragashit**. Pavarësisht se është problem i përsëritur nga vitet e mëparshme, autoritetet lokale ende nuk e kanë zgjidhur atë në mënyrë efektive. Për shkak të mungesës së besimit të tyre në reagimin me kohë të institucioneve kompetente, shumë raste të vjedhjeve nuk raportohen nga popullata lokale. Kjo mungesë raportimi mund t'i atribuohet një kombinimi faktorësh duke përfshirë mosbesimin në agjencitë ligj-zbatuese dhe kufirin poroz me Shqipërinë. Implementimi i masave të përgjegjshme dhe të dukshme ligj-zbatuese (me anë të rekrutimit të pjesëtarëve të komunitetit goran për Policinë e Kosovës), së bashku me patrullimet e rritura kufitare, mund të ketë efekt parandalues ndaj kërcënimeve të mundshme dhe të inkurajojë raportimin e incidenteve të vjedhjes.

4 Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm për të **parandaluar migrimin dërrmues** të pjesëtarëve (veçanërisht më të rinj) të komunitetit goran dhe largimin e tyre nga rajoni i Gorës (në pjesën jugore të Kosovës). Kjo do të duhej të bëhet në një mënyrë që merr parasysh potencialet e këtij rajoni, veçanërisht në lidhje me atraksionet turistike që mund të ofrojë për vizitorët vendas dhe ndërkombëtarë.

5 Përmirësimi i **qasjes në arsimin adekuat** për pjesëtarët më të rinj të komunitetit goran, si parakusht për integrimin e tyre të plotë në shoqërinë kosovare.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët:

- 1 Qasja në shërbime:** Arritja e barazisë dhe integritit gjithëpërfshirës të pjesëtarëve nga komunitetet e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve në procesin e punësimit, së bashku me lehtësimin e qasjes së tyre të barabartë në kujdes shëndetësor, arsim dhe shërbimet e ndryshme publike, mbetet tejet problematike. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve raportuan diskriminim pafre në të gjitha nivelet institucionale, veçanërisht në fushën e kujdesit shëndetësor dhe ofrimit të shërbimeve të tjera themelore sociale.
- 2 Përmirësimi i mekanizmave operacionalë të institucioneve për të luftuar diskriminimin,** si sfidë kritike me të cilën ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve për realizimin e të drejtave themelore të njeriut, gjë që gjithashtu u vu re gjatë vitit 2022, ishin vështirësitë në mbrojtjen e të drejtave themelore ligjore, pasi varfëria dhe mungesa e njohurive vazhduan të luanin rol si pengesë në avancimin e të drejtave të tyre.
- 3 Promovimi i përfshirjes së gjuhës rome** në programet e studimit në institucionet arsimore si lëndë zgjedhore, me pjesëmarrje substanciale të pjesëtarëve të komunitetit. Kjo gjithashtu përfshin përdorimin e gjuhës rome si gjuhë zyrtare në përdorim në nivel lokal në komunat e Prizrenit dhe Graçanicës.
- 4** Një numër i konsiderueshëm individësh brenda këtyre komuniteteve **nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm ligjor**, duke kufizuar mundësinë e tyre për qasje në arsim dhe përfitime sociale por edhe mundësitë për punësim, gjë që duhet të trajtohet në mënyrë holistike, pasi ky problem ka vazhduar me ngulm për një periudhë të gjatë kohore.
- 5** Gjetja e **zgjdhjes gjithëpërfshirëse për kushtet e pamjaftueshme të banimit dhe të jetesës** është thelbësore për përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës. Pjesëtarë të shumtë të komuniteteve të romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve banojnë në vendbanime joformale të karakterizuara me kushte banimi nën standarde, mungesë të infrastrukturës së duhur dhe komoditeteve thelbësore.

- 1 Shqetësimet e sigurisë:** Këto janë mbase preokupimi më i ngutshëm dhe i menjëhershëm për komunitetet serbe të Kosovës si në jug ashtu edhe në veri të lumit Ibër. Megjithëse shtrirja dhe natyra e problemit është e ndryshme, në kuptimin që shqetësime të tilla në veri rrjedhin nga prania e forcave speciale, të shpërndara në të gjithë zonën, ndërsa në jug ekziston, prej disa vitesh, një ndjenjë e përgjithësuar e cenueshmërisë që është e lidhur ngushtë me ndjenjën e mosndëshkimit dhe mungesës së interesit nga aktorët përkatës institucionalë. Duke pasur parasysh këtë, është e domosdoshme që edhe institucionet qendrore edhe ato lokale të përmirësojnë ofrimin e sigurisë për serbët e Kosovës, veçanërisht për ata që banojnë në jug të lumit Ibër. Kjo ngërthen adresimin e rasteve ligjore që përfshijnë kërcënime ndaj sigurisë personale dhe pronësore, dhe dënimin e qartë të dukurive të tilla nga zyrtarët në nivel qendror dhe lokal. Për më tepër, dhe veçanërisht në veri, kjo do të përfshinte tërheqjen e plotë të forcave speciale dhe ndalimin e ndërtimit të kundërligjshëm të bazave të policisë.
- 2 Prona dhe procesi i kthimit:** Çështja e kthimit të pronave të uzurpuara pronarëve të tyre të ligjshëm është një çështje që është veçanërisht e ngutshme në zonat në jug të lumit Ibër, veçanërisht në zonat në dhe rreth komunës së Vushtrrisë dhe në Kosovën perëndimore. Ka raportime të vazhdueshme për ngacmime të të kthyerve, dhe sistemi gjyqësor gjatë gjithë vitit 2022 ka vazhduar të jetë i ngarkuar me raste të kamotshme, me shembuj edhe më ekstremë të uzurpimit që kanë mbetur të pandëshkuar dhe pa përgjigje nga institucionet përkatëse dhe organet ligjore. Banorët e komuniteteve më të izoluar dhe më të cenueshme, d.m.th., ata që jetojnë jashtë komunave me shumicë serbe të Kosovës, pohuan se ndihen veçanërisht të pambrojtur në këtë drejtim, ku shumë prej tyre pretenduan se një pjesë e tokës së tyre u ishte marrë, por që asnjë nga autoritetet lokale nuk u kishte ofruar mjete juridike të përshtatshme për të adresuar rastet e tyre, ose se ata me vetëdije morën vendimin për të mos raportuar uzurpimin nga frika e hakmarrjes (mbase arsyeja më e zakonshme), ose nga mungesa e besimit në vullnetin e autoriteteve gjyqësore për të ndër-marrë hapat e nevojshëm për t'ua kthyer tokën e tyre.
- 3 Qasja e barabartë në shërbime:** Pjesëmarrësit e hulumtimit gjithashtu raportuan, veçanërisht ata që jetojnë në zonat rurale, vështirësi në qasjen ndaj shërbimeve publike, posaçërisht ata që banojnë në komunat me shumicë shqiptare. Këto vështirësi burojnë nga çështjet që lidhen me mungesën e zbatimit të dygjuhësisë zyrtare, si dhe sipas pretendimeve nga disa bashkëbisedues, mungesën e vullnetit për t'u angazhuar me komunitetin serb. Vlen të përmendet gjithashtu se kjo çështje shtrihej edhe në aspektet e infrastrukturës (p.sh., rrugët), të cilat shpeshherë anashkalohen. Për më tepër, serbët e Kosovës raportuan gjithashtu çështje në lidhje me marrjen e dokumenteve të identitetit të Kosovës, duke i lënë shumë në situatë të pezulluar administrative.
- 4 Trashëgimia kulturore dhe fetare:** Ka pasur incidente të vazhdueshme të politikës pronësore në dëm të Kishës Ortodokse Serbe (KOS) ose raste të vjedhjes së pasurisë së paluajtshme prej tyre. Përkundër kornizës relativisht

të fortë ligjore që ofron mbrojtje të konsiderueshme për lokalitetet e trashëgimisë kulturore, shumë nga komuniteti shqiptar i Kosovës mbeten armiqësorë ndaj këtyre, dhe përdhosja e kishave dhe manastireve mbeti ndodhi e zakonshme. Për më tepër, shumë pjesëmarrës raportuan se ishin të shqetësuar nga pretendimet që buronin nga përfaqësues politikë të shqiptarëve të Kosovës, si dhe nga akademikë dhe figura të tjera publike, në tentativë për të imponuar idenë se objektet e trashëgimisë si Manastiri i Graçanicës, Patriarkana e Pejës dhe Manastiri i Deçanit janë në të vërtetë objekte të trashëgimisë shqiptare.

- 5 Të drejtat e gjuhës:** Çështjet që lidhen me implementimin e legjislacionit dygjuhësh janë të vazhdueshme dhe mbeten kryesisht të pazgjidhura në nivel politik. Shkeljet janë të shumta, veçanërisht në ndërveprimet e përditshme të qytetarëve me institucionet.²⁰ Për më tepër, dhe gjatë gjithë vitit 2022, të punësuarit në sektorin gjyqësor vazhduan të vërejnë probleme, për shembull, në marrjen e vendimeve gjyqësore në gjuhën serbe, duke penguar aftësinë e avokatëve për të ofruar përfaqësim ligjor adekuat dhe efektiv për klientët e tyre. Një çështje tjetër me rëndësi që u ngrit në shumë raste gjatë kryerjes së hulumtimit për këtë punim ishte përdorimi i gjuhës në fusha të caktuara të sektorit privat, konkretisht nga bankat dhe ofruesit e shërbimeve të telekomunikimit, të cilët përndryshe janë të detyruar t'u përmbahen dispozitave të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve. Pjesëmarrësit e hulumtimit theksuan marrjen e kontratave dhe dokumenteve të tjera zyrtare në gjuhën shqipe, në mungesë totale të çfarëdo përkthimi në gjuhën serbe.

²⁰ Sipas hulumtimit të kryer në vitin 2023 nga Komunikimi për Zhvillim Social (nga Graçanica) në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës, 95% e të anketuarve besojnë se e drejta për të përdorur gjuhën serbe në komunikimin me institucionet nuk respektohet: *Kumtesë e Politikave: Të drejtat dhe interesat e komunitetit serb*, f. 26.

Turqit:

- 1** Për shkak të mungesës së dukshme të materialeve zyrtare të komunikimit të paraqitura në gjuhën turke në komunat ku pjesëtarët e komunitetit turk përbëjnë pjesë të ndjeshme të popullsisë, këshillohet që të ndërmerren hapa të menjëhershëm për të adresuar këtë çështje, duke **siguruar disponueshmëri të përkthyesve dhe duke ofruar informacion dhe dokumente zyrtare në gjuhën turke**, të cilat duhet të përkthehen dhe t'u ofrohen me kohë pjesëtarëve të këtij komuniteti jo-shumicë.
- 2** Institucionet e nivelit qendror, në veçanti Ministria e Arsimit, do të duhej të **adresoje mungesën e teksteve mësimore në gjuhën turke** në shkollat fillore dhe të mesme për pjesëtarët e komunitetit turk. Kjo mund të arrihet përmes krijimit të një bashkëpunimi më të ngushtë me institucionet arsimore me seli në Turqi.
- 3** Institucionet përkatëse të nivelit qendror, duke përfshirë ato që merren me çështjet e komuniteteve jo-shumicë, do të duhej të investojnë më shumë në **gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe sistematike për çështjen e papunësisë** në mesin e pjesëtarëve më të rinj të komunitetit turk, gjë që përfundimisht do të mund të trajtonte rritjen e migrimin të jashtëm në mesin e kësaj kategorie shoqërore.

- 4 Organizatat dhe shoqatat jo-qeveritare që vijnë nga komuniteti turk do të duhej të jenë më aktive në komunitet me anë të aktiviteteve që do të promovojnë më tej **gjuhën, trashëgiminë kulturore dhe identitetin turk** në mënyrë më të dukshme dhe dinamike. Në këtë drejtim, këto organizata do të duhej të mëtojnë të aplikojnë për grante që ofrohen nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror në Kosovë, si dhe nga donatorët ndërkombëtarë, në mënyrë që të rritet fushëveprimi, cilësia dhe arritja e aktiviteteve të zbatuara në mbarë Kosovën.
- 5 **Numri në rritje i uebsajteve dhe profileve të rreme në media sociale që shpërndajnë mesazhe fyese** me cak turqit e Kosovës ka ngritur shqetësim të madh në mesin e pjesëtarëve të këtij komuniteti, kërkon ndërhyrje të menjëhershme dhe vëmendje nga ana e institucioneve që merren me gjuhën e urrejtjes online dhe ngacmimet verbale.

Pjesëmarrja politike dhe përfaqësimi i komuniteteve jo-shumicë

- Partitë politike që përfaqësojnë interesat e komuniteteve jo-shumicë duhet të sigurojnë organizimin e rregullt të tubimeve konsultative me zgjedhësit e tyre. Kjo do t'u mundësojë atyre që në mënyrë efektive dhe të shpejtë të avokojnë për përmirësimin e të drejtave të këtyre komuniteteve, duke adresuar çështjet si në terma të gjerë ashtu edhe në nivele specifike, duke filluar nga çështjet e vogla deri te ato madhore.
- Pavarësisht nga dallimet ideologjike apo programore brenda komuniteteve individuale jo-shumicë, është e një rëndësie vendimtare për ta të përmirësojnë komunikimin mes vete në baza të rregullta. Kjo do të mundësojë qasje më kohezive dhe të unifikuar kur trajtohen dhe avokohet për çështje që kërkojnë zgjidhje nga perspektiva më e gjerë e bazës së zgjedhësve të tyre.
- Për shkak të natyrës së përbashkët të sfidave me të cilat përballen pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, është thelbësore që partitë politike që mbrojnë këto interesa të bashkëpunojnë më ngushtë. Duke kërkuar gjuhën e përbashkët, këto palë mund të trajtojnë në mënyrë efektive çështjet e përbashkëta dhe të punojnë drejt zgjidhjes së tyre kolektivisht, duke ushtruar kështu më shumë presion mbi palët e interesuara vendimmarrëse për të marrë parasysh zgjidhjet e propozuara të përbashkëta.
- Marrë parasysh polemikat gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 mbi të drejtat e votës për qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës, veçanërisht individët e zhvendosur që banojnë përkohësisht në Serbi, është e këshillueshme që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të rishqyrtojë vendimin që parashikon të drejtën e votës vetëm për ata që kanë dokumente të lëshuara nga institucionet e Kosovës. Bashkëpunimi me aktorët përkatës ndërkombëtarë, duke përfshirë partitë politike të komunitetit jo-shumicë, zhvillimi i një procesi më përfshirës të verifikimit mund të ndihmojë parandalimin e skualifikimit të disa kategorive të qytetarëve për të marrë pjesë në proceset zgjedhore, duke ruajtur njëkohësisht integritetin e sistemit zgjedhor.
- Për të arritur ndikim më të madh në politikëbërjen në nivel qendror, Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK), si mekanizëm i rëndësishëm institucional për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë, duhet të reformohet në atë mënyrë që të jetë në gjendje të rrisë potencialet për gjetjen e zgjidhjeve institucionale për problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë. Që të arrihet kjo, kuadri ligjor duhet të ndryshohet në mënyrë që të forcohet autoriteti vendimmarrës i KKK-së dhe respektimi i rekomandimeve të tij detyruese, duke siguruar kështu promovimin efektiv të të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Për më tepër, duhet të ndahen më shumë burime (si në aspektin financiar ashtu edhe në atë të personelit) për KKK-në, duke rritur

²¹ Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, EFEKTIVITETI I MEKANIZMAVE KONSULTATIVË TË QEVERISË NË KOSOVË: Këshilli Konsultativ për Komunitete, 2023

²²endra Humane e Mitrovicës, Kumtesë e Politikave: SIGURIA DHE MARRËDHËNIET ETNIKE NË KOSOVË – POZITA E KOMUNITETIT SERB, 2023

Liria e shprehjes/ mediave

Organizatat e shoqërisë civile nga komunitetet jo-shumicë

njëkohësisht përpjekjet për të përfshirë komunitetet jo-shumicë përmes ngjarjeve publike dhe partneriteteve me organizatat lokale të shoqërisë civile.²¹ Ndryshime të ngjashme strukturore duhet të shihen edhe në mekanizmat e tjerë institucionalë që janë në dispozicion të komuniteteve jo-shumicë: Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve.

→ Të ofrohen kushtet për zgjedhje të drejta dhe demokratike në komunat e veriut të Kosovës, me vëzhgues me reputacion dhe me angazhim më serioz të vëzhguesve nga shoqëria civile. Mekanizmi i tillë supozon paraprakisht uljen e presionit ndaj votuesve dhe vullnetin e tyre të lirë gjatë marrjes së vendimeve dhe krijon kushte për themelimin e administratave komunale që shërbejnë si shërbim për qytetarët.²²

→ Një angazhim më proaktiv i Policisë së Kosovës dhe sistemit gjyqësor është vendimtar në adresimin e incidenteve që përfshijnë gazetarët nga komunitetet jo-shumicë të cilët përballen me sulme apo kërcënime verbale apo fizike. Dështimi për të bërë përparim të ndjeshëm në kërkimin e llogarisë nga ata që kryejnë veprime të tilla mund të minojë potencialisht mirëqenien e individëve të prekur dhe besueshmërinë e shtëpive mediatike që ata përfaqësojnë.

→ Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës do të duhej të bëjë përpjekje për të përfshirë gazetarët nga komunitetet jo-shumicë dhe të angazhohet aktivisht me organizatat mediatike me të cilat nuk kanë qenë partnerë më parë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nxitjen e bashkëpunimit me mediat brenda komuniteteve të boshnjakëve, serbëve dhe goranëve.

→ Vendimmarrësit si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror do të duhej të përmbahen nga masat shtrënguese dhe/ose të presionit ndaj përfaqësuesve të mediave në përgjithësi, dhe atyre që vijnë nga komunitetet jo-shumicë në veçanti.

→ Organizatat dhe shoqatat jo-qeveritare që vijnë nga komunitetet jo-shumicë do të duhej të mëtojnë të jenë më aktive në kërkimin e mundësive për financimin e projekteve, qëllimi i të cilave është ruajtja e identiteteve të tyre të veçanta gjuhësore dhe kulturore. Nga ana tjetër, ata duhet gjithashtu të angazhohen në mënyrë aktive në monitorimin e procesit të dhënies së granteve nga nivelet lokale dhe qendrore të rezervuara për komunitetet jo-shumicë në mënyrë që ato të jenë në përputhje me ligjet përkatëse dhe që informacioni për konkurset publike dhe shpërndarja e mëvonshme e fondeve të jetë transparente, proces ky i cili do të duhej të bëhet publik në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë.

→ Kur pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë u ofrojnë mundësi për financimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ruajtjen dhe promovimin e identiteteve të tyre të veçanta, Qeveria e Kosovës dhe komuniteti i donatorëve ndërkombëtarë do të duhej t'i marrin parasysh nevojat e tyre aktuale, në vend që të përcaktojnë agjendat e veta të bazuara në strategji që nuk ishin të projektuara në koordinim të ngushtë me komunitetet lokale jo-shumicë.

→ Në mënyrë që përfaqësuesit politikë të partive politike që vijnë nga komunitetet jo-shumicë të jenë më transparentë dhe llogaridhënës,

Qasja në shërbime

organizatat jo-qeveritare do të duhej të investojnë më shumë në kryerjen e monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të tyre brenda Qeverisë dhe Kuvendit. Rol bosht në këtë proces mund të ketë raportimi i mediave në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë, të cilat mund të jenë aleat vendimtar i OSHC-ve në përpjekjet e tyre për t'i mbajtur përfaqësuesit politikë më llogaridhënës ndaj zgjedhësve të tyre.

- Të adresohen mospërputhjet sistematike në zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës serbe, boshnjake, rome dhe turke në nivel lokal dhe/ose qendror. Kjo do të përfshinte sigurimin e qasjes në informacion, përkthimin me kohë dhe eficient të informacionit në gjuhë të tjera përveç shqipes.
- Për të siguruar arritjen e qasjes më të madhe në shërbime, të ofrohen trajnime për stafin në institucionet e nivelit lokal dhe/ose qendror për të kuptuar më mirë dhe për t'u dalë ndesh nevojave të komuniteteve jo-shumicë të Kosovës. Ky lloj trajnimi nuk do të duhej të fokusohet vetëm në komunitetin serb të Kosovës, por edhe në komunitetin boshnjak, goran, turk dhe rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo do të duhej t'u ofrohet me synim punonjësve komunalë, punonjësve të kujdesit shëndetësor dhe ofruesve të shërbimeve sociale.
- Të ofrohet trajnim ndërkulturor për punonjësit publikë që punojnë në rajone me struktura të larmishme etnike dhe fetare. Ky trajnim do të duhej të fokusohet në zhvillimin e shkathtësive të komunikimit ndërkulturor dhe kuptimin më të thellë të kontekstit historik dhe kulturor të të dy komuniteteve. Kjo qasje mund të ndihmojë në zbutjen e paragjykimëve dhe stereotipave.
- Të emërohen zyrtarë ndërlidhës me komunitetin, të cilët mund të veprojnë si ndërmjetës mes ofruesve të shërbimeve publike dhe komuniteteve të cilave u shërbejnë. Këta ndërlidhës mund të lehtësojnë komunikimin, të adresojnë shqetësimet dhe të ngushtojnë hendekun mes komuniteteve dhe ofruesve të shërbimeve.
- T'u jepet prioritet zhvillimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës në zonat rurale, duke përfshirë rrugët dhe instalimet e tjera thelbësore. Lënia pas dore e infrastrukturës mund të përkeqësojë pabarazitë dhe të pengojë qasjen në shërbimet bazë. Të sigurohet që burimet ndahen në mënyrë të drejtë për të përmirësuar kushtet e jetesës për të gjithë banorët.
- Të kryhen vlerësime të rregullta të nevojave si në komunat me shumicë shqiptare ashtu edhe në komunat me shumicë serbe. Kjo mund të ndihmojë në identifikimin e sfidave specifike me të cilat përballet secili komunitet dhe të udhëzojë shpërndarjen e burimeve dhe shërbimeve në përputhje me rrethanat.
- Të krijohen mekanizma për transparencë dhe llogaridhënie në ndarjen e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve. Të ndahet rregullisht informacioni me komunitetet rreth projekteve, afateve kohore dhe buxheteve. Kjo mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit dhe të sigurojë që shërbimet ofrohen në mënyrë të drejtë.
- Të bashkëpunohet me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe përfshirjes sociale. Këto organizata mund të ofrojnë njohuri të vlefshme, të avokojnë për shërbime me drejtëri dhe të kontribuojnë në zbatimin efektiv të politikave.

Të drejtat gjuhësore

- Të organizohen seanca të dialogut ndërkomunitar për të nxitur mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb. Këto diskutime mund të ndihmojnë në adresimin e keqkuptimeve, në ndërtimin e marrëdhënieve dhe në identifikimin e synimeve të përbashkëta.
- Të sigurohet që këto rekomandime integrohen në politikat dhe strategjitë afatgjata. Zotimi i vazhdueshëm nga organet qeveritare dhe palët përkatëse të interesit është thelbësor për ndryshimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm në qasje ndaj shërbimeve dhe në marrëdhënie me komunitetin.
- Krijimi i databazës së akteve ligjore që duhet të harmonizohen me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve dhe rregulloret tjera që mbrojnë të drejtat gjuhësore në Kosovë, për shkak të ekzistimit të gabimeve të shumta në përkthimin e ligjeve dhe dokumenteve të tjera ligjërishit detyruese, të cilat përfundimisht çojnë në interpretime të ndryshme të normave juridike që kanë të njëjtin kuptim.
- Punësimi i më shumë përkthyesve në nivel qendror dhe lokal, gjë që do t'i sillte shërbimet institucionale më afër pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë përmes komunikimit në gjuhën e tyre amtare. Ky proces do të përfshinte gjithashtu trajnime profesionale dhe kurse shtesë për përkthyesit e sapo punësuar, në mënyrë që ata të jenë plotësisht të pajisur dhe të gatshëm për t'iu përgjigjur nevojave të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shumicë.
- Krijimi i mekanizmit institucional për sigurimin e cilësisë së përkthimit si në nivel qendror ashtu edhe në atë komunal në formën e një mekanizmi sistemor (koordinues) të përkthimit, korigjimit dhe redaktimit të akteve ligjore. Mekanizmi do ta bënte të pamundur publikimin e një akti ligjor pa verifikimin dhe konfirmimin paraprak të cilësisë së përkthimit.
- Krijimi i Rregullores për komunikim zyrtar brenda institucioneve të Kosovës. Komunikimi ndërinstitutional duhet të bëhet në gjuhët zyrtare, që do të thotë se të gjitha letrat, kërkesat apo ankesat që mbështesin komunikimin ndërinstitutional duhet të shkruhen në gjuhët zyrtare. Institucionet duhet të përgjigjen në gjuhën në të cilën kanë marrë letrën, kërkesën ose ankesën siç parashikohet nga rregulloret ligjore pozitive në Kosovë dhe praktika e mirë ndërkombëtare në sistemet dygjuhëshe.
- Përkthimi i përmbajtjes së uebsajteve të institucioneve qendrore dhe komunave në gjuhën serbe dhe në gjuhët e tjera të komuniteteve jo-shumicë në përdorim zyrtar në komuna.
- Krijimi i planit sistematik dhe të detajuar në formë të udhëzimit administrativ ose aktit nënligjor të veçantë lidhur me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve për zgjidhjen e çështjeve rreth përdorimit të gjuhëve të komuniteteve jo-shumicë në procedimet gjyqësore.
- Legjislacioni aktual parashikon detyrimin e institucioneve të Kosovës që të shënojnë dhe vendosin tabela topografike në të gjitha gjuhët zyrtare, duke respektuar në këtë mënyrë barazinë gjuhësore. Një fjalor shumëgjuhësh i toponimeve do të ofronte listën dhe përshkrimin e shkurtër të toponimeve në Kosovë, të cilat përfundimisht do të përdoren në të gjitha dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet e nivelit lokal dhe qendror kur publikohen në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë.²³

²³ Një listë më e detajuar dhe gjithëpërfshirëse e rekomandimeve në lidhje me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve mund të gjendet në publikimin e OJQ AKTIV, Rekomandime për një kornizë të politikave mbi zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, 2022, në dispozicion këtu: <https://ngoaktiv.org/wp-content/uploads/2022/12/2022-05-06-Preporuke-albanski.pdf>

Çështjet socio-ekonomike

Siguria dhe liria e lëvizjes

- Komuniteti ndërkombëtar do të duhej të përqendrojë më shumë përpjekje dhe mbështetje financiare në komunitetet e cenueshme në Kosovë, veçanërisht në zonat e të kthyerve dhe komunitetet e tjera të izoluar / të cenueshme. Kjo do të duhej të përfshijë bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile që punojnë në ato zona dhe ofrojnë ndihmë humanitare për njerëzit që jetojnë në ato zona.
- Për të trajtuar normat e larta të papunësisë brenda komuniteteve jo-shumicë, Qeveria do të duhej të paraqesë një strategji zyrtare gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur enkas për luftimin e papunësisë në nivel kombëtar, duke theksuar veçanërisht fuqizimin ekonomik të grave dhe personave me aftësi të kufizuara brenda këtyre komuniteteve.
- Komuniteti ndërkombëtar do të duhej të ushtrojë presion mbi Qeverinë e Kosovës që të qartësojë politikat e saj kur bëhet fjalë për përdorimin e dokumenteve serbe në Kosovë dhe të sigurojë që qasja në shtetësi dhe dokumente të Kosovës të lehtësohet duke punuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme për nxjerrjen e udhëzimeve administrative që do të qartësojnë procedurat për marrjen e dokumenteve, veçanërisht për të kthyerit dhe personat e lindur pas vitit 1999.
- Është e domosdoshme të bëhen përpjekje të përbashkëta në adresimin e shqetësimeve të ngritura nga bashkësia ndërkombëtare në lidhje me veprat penale të raportuara që kanë si cak në mënyrë specifike pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë, veçanërisht komunitetin serb, si dhe grupet e tjera të marginalizuara. Në këtë drejtim, Policia e Kosovës, gjyqësori dhe prokuroria do të duhej të bashkëpunojnë ngushtë me qëllim të sinkronizimit sistematik të aktiviteteve që në fund do të çojnë në rritjen e zgjidhjes së rasteve të incidenteve me kohë dhe në mënyrë adekuate ligjore.
- Vendimmarrësit e nivelit lokal dhe qendror do të duhej të jenë më të zëshëm në dënimin e akteve të dhunës në zonat shumetnike, duke kontribuar kështu në një ndjenjë pozitive të sigurisë dhe mbrojtje adekuate nga institucionet përkatëse.
- Institucionet relevante të nivelit lokal dhe qendror do të duhej të bëjnë hapa seriozë drejt mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe fetare të komuniteteve jo-shumicë në mënyrë të shkëputur nga ndikimi malinj i politikës. Rastet e shumta të pazgjidhura të sulmeve ndaj pronës së Kishës Ortodokse Serbe (KOS) në dy dekadat e fundit kanë dëshmuar se duhet të ndërmerren zgjidhje sistematike për mbrojtje të qëndrueshme dhe adekuate të lokaliteteve të trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe të kërkohet vëmendja e menjëhershme e të gjitha institucioneve përkatëse, duke përfshirë organizatat dhe misionet ndërkombëtare të pranishme në Kosovë.

Ky punim u botua në kuadër të projektit Rritja e Potencialit Avokues të Organizatave të Shoqërisë Civile Serbe të Kosovës, i implementuar nga OJQ AKTIV me mbështetjen financiare të Fondi Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED.) Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e OJQ-ve AKTIV dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e NED.

